



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300452/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisarjatin e Policisë së Peqinit.

Drejtuar: Z. Pëllumb KOVASHICA
Shef i Komisarjatisë të Policisë

PEQIN

Për dijëni: Z. Ilir PRODA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

ELBASAN

Për dijëni: Drejtues Madhor Z. Mehmet RRUMBULLAKU
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisarjatin e Policisë Peqin nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisarjatin e Policisë Peqin në datën 16.05.2023, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Bazuar në legjisllacionin vendas dhe standartet ndërkombëtare, MKPT mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria,

përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të migrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria dhe azilkërkuesit, si dhe institucionet psikiatrike e shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës: *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare të referuara si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mungesë të shefit të komisariatit, grupi i punës u takua me shefin e Sektorit të Krimeve të Rënda të Policisë Peqin, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Shefi i Sektorit të Krimeve të Rënda në Komisaratin e Policisë Peqin, informoi grupin e inspektimit për kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Në vijim, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo të ndaluar.

Theksojmë se, shefi i Sektorit të Krimeve të Rënda dhe punonjësit e tjerë të policisë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në datë 04.6.2022¹, konkretisht;

¹ Dërguar rekomandimi nr. K4/43-2 prot, datë 09.09.2022 “Për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë së Peqin”.

Rezultoi se nuk ishte zbatuar asnjë prej rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

1. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Peqin, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe dhomës së intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
3. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për pajisjen e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme, si tavolinë, karrige dhe llampa ndriçimi, për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.
4. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Peqin, për shtetaset femra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
5. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lyerjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare të tualetit dhe të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Peqin, si dhe rregullimin e bravave të dyerve për mbylljen e tyre.
6. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjes së pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve, kryesisht në periudhën e dimrit.
7. **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Në lidhje me rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, na informoi edhe me veprimtarinë administrative dhe kërkesat për investim drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, lidhur me krijimin e kushteve sipas standardeve për krijimin e dhomave të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për të rritur, gra, si dhe për të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Dhe janë në pritje të çeljes së fondit dhe të kryerjes së investimeve të nevojshme nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për plotësimin e kushteve të Komisarariatit të Policisë Peqin.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të dhomave të shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në konflikt me ligjin,

rekomandimet e Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Këto rekomandime nuk ju drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Në vlerësojmë se nuk është aspak serioze që me ndryshimin e titullarëve të institucioneve (Komisariateve të Policisë) të mos mbahen në vëmendje apo më keq të ndryshojë edhe qëndrimi ndaj rekomandimeve të bëra më parë nga Avokati i Popullit, sikurse ka ndodhur dhe këtë rast për mos zbatimin e rekomandimeve në Komisariatin e Policisë Peqin.

Avokati i Popullit është i ndërgjeshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varet nga njësi vendore. Çdo komisarjat duhet të demonstrojë se ka qenë konsequent në kërkimin e fondeve.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisarjatit e Policisë së Peqinit, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentat ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Në Komisarjatit e Policisë Peqin ambientet e shoqërimit **nuk ishin të ndërtuara** sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standard të punës: *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në një ndërtesë më vete nga godina kryesore e komisarjatit. Kjo ndërtesë ishte e vjetër dhe e amortizuar. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, përkatësisht 1 (një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1 (një) dhomë shoqërimi për gra dhe 1 (një) dhomë shoqërimi për të mitur.

Nga inspektimi i ambienteve të dhomave të shoqërimit u konstatua se gjendja teknike e godinës ishte e amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstruksionin e saj. Dhomat dhe ambientet në Komisarjatit e Policisë Peqin edhe pse ishin të pastra, por në vende të caktuara kishte rënë suvaja për shkak të lagështirës që ishte prezente kudo, kryesisht më e theksuar në dhomat e shoqërimit. Niveli i lagështirës ishte tej normave të pranueshme, duke patur ndikim negativ në jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe për vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, ku garantohet dhe siguria e tyre. Gjithashtu, 2 dhoma të shoqërimit ishin të pajisura me nga 1 tavolinë dhe 2 stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave, ndërsa dhoma tjetër e shoqërimit për të miturit nuk ishte e pajisur me orëditë e domosdoshme për këtë qëllim. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçimin e nevojshëm natyral. Të treja dhomat nuk kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, pasi mungonin lllampat ndriçuese në to. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, i pajisur me çezmë, që kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Dera e tualetit ishte e prishur dhe pa bravë për mbylljen e saj. Tualeti nuk plotësonte kushtet higjieno-sanitare, kishte nevojë për larje, lyerje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të tij. Në ambientet e këtij komisariati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*².

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar dhe të mitur. Kjo procedurë ndiqej nga punonjësit e policisë me personat e shoqëruar, deri në përfundim të veprimeve procedurale në zyrat e tyre të punës. Zyrat e punës së punonjësve të policisë nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave. Sa më sipër, çon në shkelje të të drejtave të tyre sipas parashikimeve të Urdhrit të Drejtorit të Policisë nr. 938, datë 24.07.2019 *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, ku parashikohet se: “Personat e shoqëruar deri në sqarimin e pozitës dhe të arsyes së shoqërimit mbahen në ruajtje dhe monitorim të punonjësit të policisë të funksionit të caktuar ose me mjete të tjera digjitale (sisteme të kamerave video – audio).

Ndërsa, mjediset e dhomave të shoqërimit, ambientet e brendshme dhe pjesa e jashtme e komisariatit ishte e survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu, në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë³. Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre.

Në Komisaratin e Policisë Peqin, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 16.05.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **27** persona, ku të gjithë ishin shtetas madhorë, ndërsa shtetas të mitur dhe shtetase femra të shoqëruara në konflikt me ligjin nuk kishte gjatë kësaj periudhe, sipas përcaktimeve të

² Kreu VII, pika 4 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” ku përcaktohet se: *“Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”*.

³ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

bëra në nenin 109 dhe 112/1⁴ të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2023 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Gjatë inspektimit u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Peqin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë së Komisarlatit të Policisë Elbasan.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Peqin “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

⁴ Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon: “Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimit, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjenealitetet; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimit; ë) punonjësën e policisë, i cili ka kryer shoqërimit.”

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁵.

Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektesë në të gjitha rubrikat e tij.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat nuk administrohej regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sa më sipër përbën çënim të standardit të parashikuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, përkatësisht në Kreun XV “Procedurat për evidentimin dhe trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar”, pika 5.1, gërma “c”⁶.

Nga inspektimi u konstatua se Komisariati i Policisë Peqin, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 nuk kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisariateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.⁷

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Peqin oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre, të cilat nuk ishin të monitoruara me sistem monitorimi me kamera. Ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore⁸.

⁵Kreu VIII, Procedura të Dokumentimit të Veprimit të Shoqërimit, parashikuar në Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁶ Punonjësi i policisë që merr ankesë/kërkesën e pasqyron atë në regjistrin e ankesë/kërkesave sipas rubrikave përkatëse, si dhe nënshkruan për këtë gjë në rubrikën përkatëse të regjistrimit.

⁷ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

⁸ Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por është konstatuar se sërish rekomandimi nuk është plotësuar.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, Komisariati i Policisë Peqin nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me fëmijët e mitur. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave, pasi nga intervistimi i tyre në zyrat e punës të specialistëve të policisë, mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht⁹.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Peqinit. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Peqin ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Peqin, për të marrë ndihmën mjekësore.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të*

intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

⁹ CPT ka rekomanduar se duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta për t'u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrestuar pa vonesë. CPT ka rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluarit/ arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë e drejtë. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.21]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Peqin, sipas kritereve që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT).
2. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Peqin, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së dhomave të shoqërimit të Komisarariatit Peqin, për eliminimin e lagështirës së dhomave të shoqërimit, si dhe të tualeteve në këtë institucion.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe dhomës së intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për të pajisur dhomat e shoqërimit me orënditë e nevojshme, si tavolinë, karrige dhe llampa ndriçimi, për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Peqin, për shtetaset femra të shoqëruara, të ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lysterjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare të tualetit dhe të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Peqin, si dhe rregullimin e bravave të dymëve për mbylljen e tyre.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
9. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

10. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në Komisarriatin e Policisë Peqin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI